



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, më 14 prill, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, duke konstatuar se vazhdon të ekzistojë rreziku që të akuzuarit të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses vuri në dukje se, megjithëse Prokuroria nuk synon të thërrasë dëshmitarë të tjerë, emrat e dëshmitarëve tejet të cenueshëm janë nxjerrë për Mbrojtjen, çka shton rrezikun që ky informacion i ndjeshëm të bëhet i njohur për publikun. Trupi Gjykses theksoi se ky rrezik mund të materializohet jo vetëm përpara se dëshmitarët japin dëshmi, por edhe pasi e kanë dhënë dëshminë, duke pasur parasysh se shumë prej dëshmitarëve kanë masa mbrojtëse dhe identiteti i tyre nuk duhet të bëhet i njohur për publikun.

Më 11 prill, Paneli i Apelit hodhi poshtë apelin e Mbrojtjes së Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit dhe urdhëroi palët të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve përkatëse të tyre. Mbrojtja pretendoi se ishte dëmtuar, për shkak se kur Trupi Gjykses mori në pyetje një dëshmitar, ai iu referua një deklaratë të dëshmitarit në të cilën Prokuroria kishte deklaruar se nuk do të mbështetej më gjatë gjykimit. Paneli i Apelit i kujtoi Mbrojtjes se ajo e kishte deklaruar dëshmitarit në fjalë dhe rrjedhimisht e ishte njohur me të plotësisht.

Paneli i Apelit theksoi se Rregullorja i lejon Trupit Gjykses t'u bëjë dëshmitarëve çfarëdo pyetjesh që i gjykon të nevojshme për qartësimin e dëshmive të tyre ose për zbulimin e të vërtetës, me kusht që kjo të mos çojë në perceptim të njëanshmërisë. Paneli i Apelit konstatoi se transkripti i seancës në fjalë tregon qartë se Trupi Gjykses bëri pyetje në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit që dha dëshmi, çka nuk i shkaktoi dëm Mbrojtjes.

Më 11 prill, Trupi Gjykses miratoi propozime të Prokurorisë, Njësisë për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Viktimave dhe Mbrojtësit të Viktimave për një version me më pak redakte të transkripteve të dëshmive të dy dëshmitarëve dhe pjesën tjetër të këtyre transkripteve i riklasifikoi si publike.

Më 15 prill, Prokuroria përfundoi zyrtarisht paraqitjen e provave të saj. Më 16 prill, ekipet e Mbrojtjes në këtë çështje gjyqësore njoftuan bashkërisht Trupin Gjykses se synojnë të dorëzojnë kërkesë për rrëzimin e disa ose të të gjitha akuzave në aktakuzë.

Hapat e ardhshëm në këtë çështje gjyqësore do të diskutohen në konferencën për ecurinë e çështjes të caktuar më 23 prill, duke filluar në orën 10:00 paradite.





Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu dhe Hajredin Kuçi* për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, më 14 prill, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendim në vijim të vendimit të Panelit të Apelit të javës së kaluar, ku ai konstatoi se në këtë rast zbatohet forma e tretë e nxitjes sipas nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës. Paneli i Apelit ia ktheu këtë pikë Gjykatësës së Procedurës Paraprake për të vlerësuar nëse provat mbështesnin konfirmimin e një forme shtesë të përgjegjësisë penale, që fillimisht ishte hedhur poshtë.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujtoi se, bazuar në materialin mbështetës, z. Thaçi si udhëheqës dhe përfitues kryesor i përpjekjeve penguese, nxiti kryerjen e këtyre veprave penale duke i dhënë detyrë z. Smakaj, z. Kilaj dhe z. Fazliu të kontaktonin dëshmitarë të ndryshëm; duke u zbuluar atyre informacion të mbrojtur në mënyrë të përsëritur dhe të qëllimshme, dhe duke i treguar identitetin e personave të mbrojtur zotit Kilaj dhe personi tjetër.

Krahas kësaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se materiali mbështetës tregonte se z. Thaçi inkurajoi dhe nxiti zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu, brenda grupeve përkatëse të tyre, të merrnin dhe t'i mbanin mend udhëzimet e sakta të tij dhe të kontaktonin dëshmitarë të caktuar për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e tyre para Dhomave të Specializuara. Sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake, veprimet e qëllimshme dhe inkurajimet dhe nxitjet, sikurse shtjellohen në Vendimin e Konfirmimit, tregojnë synimin e drejtpërdrejtë të z. Thaçi për të nxitur kryerjen e tentativës për pengimin e personave zyrtarë nga zotërinjtë Smakaj, Kilaj dhe Fazliu.

Si rezultat, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi formën e përgjegjësisë penale shtesë për z. Thaçi në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës dhe urdhëroi Prokurorinë të parashtronte Aktakuzën e Konfirmuar të ndryshuar të re deri jo më vonë se të mërkurën, 16 prill 2025. Gjykatësja e Procedurës Paraprake shprehu mendimin se paraqitja e parë e mëtejshme e z. Thaçi nuk ishte e domosdoshme, duke pasur parasysh se Aktakuzës iu shtua vetëm një formë e re e nxitjes, e jo një pikë e re, dhe se z. Thaçi është informuar lidhur me veprën penale dhe me formën bazë të nxitjes.

Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se pozita e z. Thaçi në lidhje me formën e përgjegjësisë penale të re duhet të dokumentohet zyrtarisht dhe rrjedhimisht ai u ftua të deklarohej në lidhje me fajësinë ose pafajësinë. Duke pasur parasysh se deklarimin e parë si i pafajshëm z. Thaçi e kishte bërë me shkrim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e urdhëroi të vetëdeklarohet me shkrim në lidhje me fajësinë ose pafajësinë për këtë aspekt deri të enjten, 24 prill. Në qoftë se z. Thaçi vendos të mos vetëdeklarohet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake bën deklarin në emër të tij si i pafajshëm. Në qoftë se z. Thaçi dëshiron të informohet në seancë të hapur në lidhje me formën shtesë të nxitjes për pikën ekzistuese të aktakuzës dhe të vetëdeklarohet gjatë saj, ai duhet të paraqesë kërkesë deri jo më vonë se të enjten, 24 prill, në orën 16:00.





Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi Zyrën Administrative që t'ua dorëzojë menjëherë aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar të re të akuzuarit dhe zotërinjve Smakaj, Fazliu, Kilaj dhe Kuçi në shqipe.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 11 prill, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi një kërkesë të Prokurorisë që të nxirrte për Mbrojtjen dy dokumente shtesë që synon t'i përdorë në gjykim, duke konstatuar se Prokuroria ka treguar arsye bindëse që përligjin ndryshimin e afatit të caktuar paraprakisht më 17 shkurt. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi më tej se nxjerrja nuk do t'i shkaktojë dëm të papërligjur Mbrojtjes. Prokuroria kishte shpjeguar se dokumentet shtesë do të përmirësonin të kuptuarit e përgjithshëm të provave të nxjerra më parë. Mbrojtja nuk e ka kundërshtuar nxjerrjen e propozuar dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se Mbrojtja do të ketë kohë të mjaftueshme të analizojë dokumentet shtesë sepse kanë kuadër të kufizuar.

Më 15 prill, u bë publik një vendim i Gjykatës së Procedurës Paraprake i 27 marsit, në të cilin hodhi poshtë kërkesën e Haxhi Shalës për lirim të përkohshëm në bazë të arsyeve humanitare bindëse. Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se z. Shala nuk vërtetoi lidhje të ngushtë me personin e përmendur në kërkesë dhe nuk as nuk dorëzoi raporte mjekësore përkatëse. Për këtë arsye, ajo konstatoi se z. Shala nuk vërtetoi ekzistencën e arsyeve humanitare bindëse dhe të jashtëzakonshme që përligjin lirimin e përkohshëm.

